

## KOMISIONI I KUALIFIKIMIT

Provimi i pranimit në Programin e Trajnimit Fillestar për Përmbarues Gjyqësor Privat

Tiranë, më 15 mars 2023

### TEZA NR. 1

**25 pyetje – 4 pikë për çdo pyetje – gjithsej 100 pikë**

Cili nga pohimet e mëposhtme është i vërtetë? – Vetëm njëra prej alternativave është e saktë.

**1. Sistemi i qeverisjes në Republikën e Shqipërisë bazohet:**

- a) në ndarjen dhe balancimin ndërmjet pushteteve ligjvënës, ekzekutiv dhe gjyqësor;
- b) në përparësinë e pushtetit ligjvënës mbi pushtetet e tjera;
- c) në përparësinë e pushtetit ekzekutiv mbi pushtetin gjyqësor.

**2. Nëpunësit në administratën publike:**

- a) caktohen mbi bazën e përkatësisë së tyre në partinë që ka shumicën në pushtetin ligjvënës;
- b) caktohen mbi bazën e vullnetit të titullarit të institucionit;
- c) caktohen me konkurs, me përjashtim të rasteve të parashikuara nga ligji.

**3. Personi fizik, në të drejtën civile:**

- a) e fiton zotësinë juridike me mbushjen e moshës 14 vjeç dhe e humbet atë në çastin e vdekjes;
- b) fiton zotësi të kufizuar për të vepruar me mbushjen e moshës 16 vjeç;
- c) nuk ka zotësi për të vepruar nën moshën 14 vjeç.

**4. Nuk parashkruhen:**

- a) paditë për kërkimin e shpërblimit për shkaktimin e dëmit jashtëkontraktor;
- b) paditë për pagimin e qirave të banesave, dyqaneve, lokaleve dhe pasurive të tjera të paluajtshme.
- c) paditë e pjesëtimit midis bashkëpronarëve.

**5. Trashëgimia me ligj zbatohet:**



- a) në rast se trashëgimlënësi nuk ka disponuar me testament për pasurinë e tij;
- b) në rast se testamenti olograf nuk është shkruar në gjuhën shqipe;
- c) në rast se testamenti nuk është hartuar nga noteri.

**6. Titulli ekzekutiv vihet në ekzekutim nëpërmjet lëshimit të urdhrit të ekzekutimit, i cili:**

- a) për rastet e vendimeve gjyqësore shqiptare lëshohet nga gjykata që ka dhënë vendimin në dispozitivin e vendimit;
- b) për vendimet e gjykatave të shteteve të huaja e të gjykatave të arbitrazhit të huaj, mjafton njohja e tyre nga gjykatat shqiptare, pa u shprehur për lëshimin e urdhrit të ekzekutimit;
- c) për titujt e tjerë ekzekutivë nuk është i nevojshëm lëshimi i urdhrit të ekzekutimit.

**7. Ekzekutimi i detyrueshëm mund të bëhet vetëm në bazë të një titulli ekzekutiv. Janë tituj ekzekutivë:**

- a) vendimet civile të formës së prerë të gjykatës, që përbajnë një detyrim, vendimet e dhëna prej saj për sigurimin e padisë, si dhe për ekzekutimin e përkohshëm;
- b) vendimet penale të formës së prerë që përbajnë dënim me burgim;
- c) vendimet gjyqësore që vërtetojnë një fakt juridik.

**8. Përmbaruesi gjyqësor, kur fillon ekzekutimin, i dërgon debitorit një lajmërim për të ekzekutuar:**

- a) menjëherë titullin ekzekutiv, ndryshe do të vijohet me ekzekutimin e detyrueshëm;
- b) vullnetarisht detyrimin që përmban urdhri i ekzekutimit, duke i caktuar për këtë një afat prej 5 ditësh, kur objekti i tij është pagë ose detyrim për ushqim dhe prej 10 ditësh në të gjitha rastet e tjera;
- c) brenda një afati të arsyeshëm titullin ekzekutiv, sipas rr Ethanave dhe situatës financiare që gjendet debitori.

**9. Në Republikën e Shqipërisë shërbimi përmbarimor:**

- a) është shërbim publik dhe privat;
- b) është në çdo rast shërbim publik, pavarësisht se ushtrohet edhe nga përmbaruesit gjyqësorë privatë;
- c) drejtohet nga ministri i Drejtësisë, urdhrat e të cilit, edhe për çështje përmbarimore të veçanta, janë të detyrueshme për përmbaruesin gjyqësor.

**10. Përmbaruesi gjyqësor privat, krahas veprimtarisë parësore, ushtron edhe veprimtari dytësore, për:**



The image shows four handwritten signatures in blue ink, each enclosed in a small rectangular box. From left to right, the signatures belong to: Mr. Lulzim Basha, Mr. Arben Celi, Mr. Gent Sejdiu, and Mr. Blerim Gashi. The signatures are fluid and unique to each individual.

- a) kryerjen e njoftimit të akteve gjyqësore dhe dokumenteve zyrtare;
- b) marrjen e masave disiplinore ndaj ekspertëve;
- c) dënimin me gjobë të drejtuesve të personave juridikë publikë që pengojnë ekzekutimin e titullit ekzekutiv.

**11. Zyrat e përmbarimit privat duhet të kenë si objekt të veprimtarisë së saj tregtare:**

- a) vetëm shërbimin përmbarim;
- b) krahas shërbimit përmbarim, edhe atë të noterisë;
- c) përveç shërbimit në fushën e përmbarimit, edhe çdo aktivitet tjetër që ka lidhje me ofrimin e shërbimeve në fushën ligjore.

**12. Përmbaruesi gjyqësor privat:**

- a) në asnjë rast dhe për asnjë shkak nuk mund të refuzojë një kërkesë për vënien në ekzekutim të një titulli ekzekutiv;
- b) mund të refuzojë, për shkaqe të parashikuara në ligj, një kërkesë për venie në ekzekutim dhe/ose kryerjen e veprimeve të ekzekutimit;
- c) vlerëson vetë nëse do të kryejë veprime përmbarimore për ekzekutimin e një titulli ekzekutiv.

**13. Përmbaruesi gjyqësor privat është i detyruar të mos pranojë kërkesën për venie në ekzekutim ose të heqë dorë nga ekzekutimi kur ky ka filluar:**

- a) kur ai ka njojje të largëta me palën debitore;
- b) kur ai banon në një bllok pallatesh me kreditorin;
- c) kur njëri prej ortakëve të zyrës së tij përmbarimore gjendet në kushtet e konfliktit të interesit.

**14. Programi i trajnimit filletar i kandidatëve për përmbarues gjyqësorë privatë:**

- a) nuk është i detyrueshëm për individët që kanë të paktën 3 vjet përvojë pune në strukturat e Ministrisë së Drejtësisë;
- b) nuk është i detyrueshëm për individët që kanë punuar më parë si përmbarues gjyqësorë shtetërorë;
- c) është i detyrueshëm për cilindo që kërkon të licencohej si përmbarues gjyqësor privat.

**15. Programi i Trajnimit Vazhdues:**

- a) është i detyrueshëm për përmbaruesit gjyqësorë privatë;
- b) është i detyrueshëm për përmbaruesit dhe ndihmëspërmbaruesit;

- c) është i detyrueshëm për çdo individ që kërkon të fitojë njohuri në shumën e ekzekutimit të detyrueshëm.

**16. Përmbaruesit gjyqësor i hiqet licenca dhe çregjistrohet nga registrat në rastet kur:**

- a) ministri i Drejtësisë vlereson se përmbaruesi nuk është i aftë profesionalisht të kryejë detyrën;
- b) bëhet i paaftë për punë për një periudhë më të gjatë se një muaj;
- c) dënohet penalisht me një vendim të formës së prerë të gjykatës, për kryerjen e një vepre penale, sipas përcaktimeve të bëra në ligj.

**17. Përmbaruesi gjyqësor privat ka të drejtë:**

- a) të përfitojë një tarifë fikse dhe tarifë suksesi në referim të kontratës së shërbimit ose marrëveshjes me palën kreditore, në përputhje me parashikimet e këtij ligji;
- b) të refuzojë ekzekutimin e një detyrimi, kur konstaton pamundësinë e debitorit për të shlyer detyrimin;
- c) të refuzojë ekzekutimin kur debitori është një organ i administratës publike.

**18. Përmbaruesi gjyqësor privat, gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij, i lejohet kryerja e veprimeve të mëposhtme:**

- a) përdorimi i mjeteve dhe forcave të Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit, sipas kërkesës për ndihmë të përmbaruesit, për shembjen e një ndërtimi të paligjshëm;
- b) përdorimi i fjalëve të pahijshme, që cenojnë reputacionin apo dinjitetin e subjekteve, që i nënshtrohen ekzekutimit të detyruar;
- c) çdo veprim tjetër me karakter mashtrees, i cili do të komprometonte rëndë besimin e palëve dhe integritetin moral të përmbaruesit gjyqësor privat.

**19. Përmbaruesi gjyqësor privat që kryen veprimtarinë e tij përmbarimore në kundërshtim me ligjin:**

- a) mban përgjegjësi vetjake për dëmin që u shkakton palëve në proces ekzekutimi, si dhe për dëmin ndaj të tretëve;
- b) nuk mban përgjegjësi pasurore ndaj palëve në proces ekzekutimi;
- c) përgjegjësia e përmbaruesit nuk shtrihet te persona të tretë, edhe pse interesat e tyre janë cenuar gjatë procesit të ekzekutimit.

**20. Përmbaruesi gjyqësor privat mund të përfitojë një tarifë suksesi:**

- a) në çdo rast të ekzekutimit të suksesshëm të detyrimit;
- b) vetëm në qoftë se për këtë tarifë ka një marrëveshje paraprake me shkrim ndërmjet përmbaruesit dhe kreditorit;

- c) vetëm në rast se tarifa e suksesit pranohet të paguhet nga debitori.

**21. Në cilësinë e zyrtarit publik, përmbaruesi gjyqësor privat refuzon kryerjen e veprimeve për ekzekutimin e një titulli ekzekutiv vetëm në rastet e mëposhtme:**

- a) kur veprimi është në kundërshtim me ligjin ose rendin publik;
- b) kur procedura e ekzekutimit kërkon kryerjen e veprimeve përmbarimore që kërkojnë mbështetjen e forcave të Policisë së Shtetit, organe të qeverisjes vendore dhe ekspertëve të fushave të caktuara;
- c) kur një veprim i tillë kërcohët nga debitori.

**22. Parimi i konfidencialitetit dhe sekretit profesional të përmbaruesit gjyqësor privat:**

- a) ndalon që aktet e ndodhura në arkivin e përmbaruesit të bëhen të njoitura, pavarësisht se cili person apo institucion kërkon të njihet me to;
- b) nënkupton që të dhënat që përmbaruesi dokumenton në procesverbalet përkatëse nuk mund të konsultohen nga persona apo institucione që nuk tregojnë interesin e tyre të ligjshëm për këtë qëllim;
- c) në çdo rast, e drejta e njoħjes me aktet e ndodhura në arkivin e përmbaruesit nuk mund të kufizohet, pasi ka përparësi transparenca që veprimitaria përmbarimore t'i nënshtrohet kritikës së publikut.

**23. Në rast konflikti ndërmjet përmbaruesve gjyqësorë privatë në lidhje me ushtrimin e veprimtarisë profesionale përmbarimore:**

- a) secili prej përmbaruesve mund t'i kërkojë ministrit të Drejtësisë zgjidhjen e tij;
- b) vetëm gjykata kompetente ka pushtetin për zgjidhjen e konfliktit;
- c) Dhoma Kombëtare e Përmbaruesve Gjyqësorë Privatë zgjidh, për sa është e mundur, konfliktin ndërmjet përmbaruesve gjyqësorë privatë.

**24. Individ, që kërkon të licencohej si përmbarues gjyqësor privat, duhet të plotësojë kushtet e mëposhtme:**

- a) të ketë përvjohje të mëparshme si përmbarues gjyqësor shtetëror;
- b) të ketë kaluar me sukses provimin e kualifikimit si përmbarues gjyqësor privat;
- c) të mos jetë dënuar ndonjëherë administrativisht për kryerjen e kundërvajtjeje administrative.

**25. Përmbaruesi gjyqësor privat ka të drejtë të paraqesë kallëzim penal:**

- a) ndaj debitorit që nuk pranon të pagujë vullnetarisht detyrimin;
- b) ndaj personave që fshehin, deklarojnë dhe/ose japid të dhëna të pasakta në lidhje me prona, të ardhura, të drejta mbi pasuritë e debitorit, të kërkua nga përmbaruesi gjyqësor privat;
- c) ndaj kreditorit për mospagimin e tarifës përmbarimore.